

VENDIM
Nr. 113, datë 6.3.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 620, DATË 1.11.2023, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË INOVACIONIT DHE EKSELENCËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të neneve 6 e 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 620, datë 1.11.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, të kreut I, fjalët “... në varësi të Kryeministrit ...” zëvendësohen me “... në varësi të ministrit përgjegjës për inovacionin ...”.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 2, fjalët “... i cili përgjigjet para Kryeministrit ...” zëvendësohen me “... i cili përgjigjet para ministrit përgjegjës për inovacionin ...”;

b) pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për inovacionin.”;

c) në shkronjën “dh”, të pikës 11, fjalët “... të caktuar nga Kryeministri, ...” zëvendësohen me “... të caktuar nga ministri përgjegjës për inovacionin, ...”;

ç) në pikën 15, fjalët “... miratohet nga Kryeministri ...” zëvendësohen me “... miratohet nga ministri përgjegjës për inovacionin ...”.

II. Ngarkohen Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama